



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “NN INGINERING MSH” të datës 21.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “126 Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc” me nr. të prokurimit 616-24-5067-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “NN INGINERING MSH” të datës 21.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “126 Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc” me nr. të prokurimit 616-24-5067-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “NN INGINERING MSH” Sh.P.K. (“parashtruesi”) me datë 21.06.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “126 Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc” me nr. të prokurimit 616-24-5067-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

### **Pretendimet ankimore të parashtruesit:**

*“PRETENDIMI NR.1 Sipas AK ne nuk kemi plotësuar kërkesën e FDT-së sa I përket kontratave dhe referencave të natyrës së projektit në vlerën e kërkuar prej: 150,000.00 euro. Kjo nuk qëndron sepse ne kemi dorëzuar një Listë të projeteve të vulosur dhe nënshkruar e cila gjendet në dokumentin e quajtur: Kontratat dhe referencat e cila listë është pjesë e Dosjes së dorëzuar dhe vlera e këtyre projekteve të ngjajshme të realizuara nga ana jonë, jo që e arrin vlerën 150,000.00 euro por është dukshëm mbi këtë vlerë. Nëse AK ka pas diqka të pa kuartë sa I përket kesaj pike, atëher conform nenit 72 të LPP-së si dhe Neni 38 Sqarimi i Tenderëve të Rregullores për Prokurim Publik eshte dashur te kerkoje sqarime”.*

*“PRETENDIMI NR.2 AK në arësyetimin tjetër për eliminim ka cekur se OE nuk ka ofruar Listën e përgjithshme të punëtorëve min 15 punëtorë (përfshirë stafin profesional) e nënshkruar dhe vulosur. Në në dosjen e dorëzuar kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara për punëtorë, përfshirë stafin profesional. Kësaj kërkesë për rishqyrtim po I bashkangjesim Listën e cila I ka të dhënat komplet siq I kemi dorëzuar dëshmitë për punëtor dhe staf profesional dhe AK është dashur që të shfrytëzojë nenin 72 pika 2 dhe 3 per te kerkuar sqarime e jo te na eliminoje ne kundershtrim me kete nen”.*

*“PRETENDIMI NR.3 AK ka cekur se ne nuk kemi ofruar dëshmi për menaxherin e projektit I cili ka përvojën e kërkuar me FDT dhe kontrata për përvojën e punës profesionale të fushës së kontratave të ngjajshme min. 10 vite pas diplomimit. Kjo nuk qëndron sepse ne kemi ofruar të gjitha dëshmitë e kërkuara me FDT për inxhinierin z.Fatmir Kryeziu I cili me profesion është Inxhinier I Diplomuar I Ndërtimtarisë, ka diplomuar me 19.12.2005 dhe ka 18 vite përvojë punë në projekte të ngjajshme. Pjesë e ofertës sonë është dokumentacioni I emeruar ING-Konstruktiv Fatmir Kryeziu” te cilit file I janë bashkangjitur të gjitha dëshmitë e kërkuara me FDT, kontrata, CV, përvoja, projektet. Pra jemi të befashuar pse për këtë pikë AK ka deklaruar se mungojnë dëshmitë, ose ju ka ndodhur ndonë gabim gjatë fazës së vlerësimit të këtyre dëshmive. Edhe pika tjetër në vijim ku AK thotë se për inxhinierin e ndërtimtarisë nuk ka ofruar CVnë e nënshkruar, kjo nuk qëndron fare sepse Inxhinieri z.Fatmir Kryeziu e ka të nënshkruar CV-në, ju lutem shikojeni dëshmitë te ky inxhinier”.*

*“PRETENDIMI NR.4 AK ka cekursi arësye ku thotë se dy Teknik Drejtimi I ndërtimtarisë mungojnë CV-të. Kjo qështje është e rregulluar me UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve: CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar - Mund të kërkojen informata sqaruese 69. Pra AK është dashur që konform nenit 72 të LPP-së dhe nenit 10 të Udhëzuesit të na kërkojë CV-të të cilat po I bashkangjesim kësaj kërkesë e të cilat janë dëshmi shtesë për stafin e kërkuar me FDT”.*

*“PRETENDIMI NR.5 AK në arësyein tjetër për eliminim ka cekur se Leotrim Bllaca nuk ka ofruar dëshmi një kontratë të përfunduar me natyrën e kontratës të jenë të bashkangjitur referencat origjinale ose të noterizuara. Edhe kjo nuk qëndron sepse të njëjtat dëshmi në origjinal I kemi në dokumentin e quajtur: BACH-Leotrim Bllaca”.*

*“PRETENDIMI NR.6 Në arësyein e fundit AK ka cekur se ne nuk kemi ofruar dëshmi Listën e pajisjeve, por jo nuk qëndron sepse ne kemi ofruar komplet dëshmitë për pajisjet e kërkuara me FDT dhe kemi plotësuar kërkesat e AK sa I përket pajisjeve, për këtë qështje AK ka mundur të kërkojë sqarime konformë nenit 72 të LPP-së sepse është e njëjta situatë siq specifikohet në udhëzim të prokurimit kur thuhet se mungon Lista e projekteve por janë ofruar dëshmitë atëher Udhëzuesi obligon AK të kërkojnë sqarime, e e njëjta situatë është edhe të pajisjet ne kemi ofruar të gjitha dëshmitë. Lista e pajisjeve e cila nuk është kërkuar konform nenit 72 të LPP-së është bashkangjitur kesaj kërkesë për rishqyrtim si dëshmi shtesë për dëshmitë e ofruara për pajisje në ofertën tonë”.*

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

<p>Komisioni i vlerësimit ka konstatuar disa të gjetura nga vlerësimi i ofertës së vetme të dorëzuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* Operatori Ekonomik nuk ka ofruar dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata në vlerë 150000€ të shërbimeve në lëminë e fushës së kontratave për tre vitet e fundit.</li> <li>* Operatori Ekonomik nuk ka ofruar dëshmi listën e përgjithshme të punëtorëve min. 15 punëtorë (përfshirë stafin profesional) e nënshkruar dhe vëlosur.</li> </ul> <p><i>Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar: tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt.</i></p> <p><b>B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>* Operatori Ekonomik për menaxherin e projektit nuk ka ofruar dëshmi kontrata mbi përvlojen e punës profesionale të fushës së kontratave apo të ngjashme min.10 vite pas diplomimit.</li> <li>* Operatori Ekonomik për Inxhinierin e Ndërtimit nuk ka ofruar dëshmi kontrata mbi përvlojen e punës profesionale min.5 vite pas diplomimit.</li> <li>* Operatori Ekonomik për dy Teknik-Drejtimin i Ndërtimit nuk ka ofruar dëshmi kontrata mbi nënshkrimin e CV-it.</li> <li>* Leotrim Bllaca nuk ka ofruar dëshmi një kontrate të përfunduar me natyrën e kontratës, të jetë bashkangjitur referencat origjinale apo të noterizuar.</li> <li>* Operatori ekonomik nuk ka ofruar dëshmi listën e pajisjeve të nënshkruar dhe vëlosur.</li> </ul>	

Lidhur me pretendimin nr. 1 duhet cekur se kërkesa e dosjes së tenderit është si në vijim:

Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare
Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses Kontrata në vlerë minimale 150 000 € të shërbimeve të ekzekutuara në lëminë e fushës së kontratës apo të ngjashme, për tre vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Për grupin e Operatoreve Ekonomik, lideri duhet të plotësoi 60% të kërkesës.	Një listë të kontratave dhe referenca ose pranime teknike për shërbime në lëminë e kërkuar apo të ngjashme, për 3 (tre) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e shërbimeve (Kontrata dhe Referencat duhet të korrespondojnë me njëra tjetrën).

Parashtruesi ka dorëzuar një listë të kontratave ku ka evidentuar gjithsej 23 kontrata. Mirëpo në mesin e tyre vetëm 16 prezantohen si kontrata të përfunduara në 3 vitet e fundit para njoftimit për kontratë ndërsa 7 të tjera janë përfunduar më herët sesa në 3 vitet e fundit para njoftimit për kontratë. Rrjedhimisht 16 kontratat e prezantuara si

kontrata në 3 vitet e fundit para njoftimit për kontratë sipas listës së parashtruesit kanë vlerë vetëm rreth 139 mijë euro pra dukshëm më pak sesa 150 mijë euro sa janë kërkuar me dosjen e tenderit. Në këtë mënyrë është gjetur se nuk është përmbushur kërkesa e dosjes së tenderit dhe oferta e parashtruesit është ofertë e papërgjegjshme. Kjo përcaktohet edhe përmes UPP ku thuhet se në rastet kur lista e kontratave nuk përmbushë vlerën minimale tenderi refuzohet pa kërkuar informacione shtesë.

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve		
10.1 <i>Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së</i>		
Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Lidhur me pretendimin nr. 2 duhet cekur se kërkesa e dosjes së tenderit është si në vijim:

Lista e përgjithshme e punëtorëve e OE, duhet të i ketë min. 15 punëtor. Vërejtje Staf i kërkuar profesional (i prezantuar) duhet të jetë aktivisht i angazhuar në zbatim të kontratës.	Lista e punëtorëve (përfshirë stafin profesional) e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik
---	---

Nga administrimi me dokumentet e ofertës së parashtruesit është gjetur se nuk është dorëzuar fare lista e punonjësve nga parashtruesi. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi pasi që në kërkesën për rishqyrtim konfirmohet se nuk është dorëzuar lista e punonjësve. Megjithatë parashtruesi aludon se AK është dashur që të kërkoj sqarime shtesë. Kjo nuk është e mundur sepse AK-së nuk i lejohet që të kërkoj sqarime shtesë mbi një dokument që mungon (që nuk është dorëzuar fare) por mund të kërkoj sqarime vetëm mbi bazën e dokumenteve që janë dorëzuar me kusht që sqarimet të jenë të ndërlidhura me atë dokument. Ky fakt konfirmohet edhe nga UPP ku në pikën 10 askund nuk thuhet se AK mund të kërkoj sqarime shtesë kur mungon lista e punëtorëve. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka përmbushur as këtë kërkesë të DT.

Lidhur me pretendimin nr. 3 duhet cekur se kërkesa e dosjes së tenderit është si në vijim:

Menaxher i projektit (kontratës) Vërejtje Menaxheri duhet të jetë me profesion nga fusha e inxhinierisë së ndërtimit – drejtimi konstruktivë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diplomë universitare e programit Master (apo 4 vjetë e sipër, programi i vjetër në Kosovë) – Kopje e Noterizuar(jo më e vjetër se 6 muaj);</li> <li>• Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati;</li> <li>• Dy(2)kontrata të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat origjinale apo të noterizuara;</li> <li>• Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët;</li> <li>• Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min. 10 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontrates (Kontratave me punëdhënësit) së punës;</li> </ul>
---	--

Sipas kërkesës së DT është kërkuar që përvoja e punës (min. 10 vite pas diplomimit) duhet të dëshmohet përmes kontratave me punëdhënësin/it përkatës. Në ofertën e parashtruesit është gjetur se parashtruesi nuk ka dorëzuar fare kontratat përkatëse të punës për të dëshmuar përvojën e punës. Rrjedhimisht nuk është përmbushur as kjo kërkesë e dosjes së tenderit. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 4 nuk është kontestues fakti që nuk janë dorëzuar CV për 2 teknikët e ndërtimtarisë sepse këtë fakt nuk e konteston as vet parashtruesi. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Vlen të shtohet se parashtruesi nuk e ka kontestuar fare të gjeturat eliminuese sipas komisionit vlerësues lidhur me inxhinierin e ndërtimtarisë.

Lidhur me pretendimin nr. 5 dhe 6, është gjetur se këto pretendime janë pjesërisht të bazuara mirëpo duke marrë parasysh të gjeturat tjera sipas të cilat në mënyrë të pakontestueshme është gjetur se oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme, rivlerësimi eventual nuk do të mund të ndryshonte epilogun e aktivitetit të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 01.07.2024**

**Visar SHEHU**  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.